# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441974**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e me ritoj çmimin |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/lufta-per-topin-e-arte-lamine-yamal-une-dhe-mbappe-jemi-dy-me-te-miret-por-kete-vit-mendoj-se-e-meritoj-cmimin/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 06:04:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 05:58:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 05:57:00 UTC → 14 shtator 2026, 05:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 557c8e55b04efb81d71a60a5bdea2d6422803a571d50345dd7d26e5422a03887 |
| TEKSTI | cb52d05919ef7e8145d9de4e1bacb32bd11c2929d6cb7c099dc3726fb22af7bf |
| PAMJA | cd26b69fb3b6a980251208809405cb0d5085469b1c2b759b10950d2523e2d986 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | a3bd30fb02d1985bb18f62622d1b67272b62034543c4a6d066de71ca71771013 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | ffd91b584b7f6ad6fe6fe6255283fcbda7dbe303bf00ea6d85b435b755931683 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a3bd30fb02d1985bb18f62622d1b67272b62034543c4a6d066de71ca71771013`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e meritoj çmimin

14/09/2026 07:58




**Lamine Yamal foli për paraqitjen e tij në fushë, ku këtë të diel, në stadiumin "Ciutat de València", shënoi dy gola të tjerë dhe u ngjit në krye të listës së golashënuesve të La Ligës, duke barazuar me nga gjashtë gola Raphinha, Mbappé dhe Camello.**

Por sulmuesi i Barcelonës foli edhe për atë që ndodh jashtë fushës. Në një pjesë të intervistës për "Universo Valdano", e cila do të transmetohet më 18 shtator në Movistar+ në orën 21:00, Yamal u shpreh hapur për kandidaturën e tij për të fituar "Topin e Artë", çmim që do të dorëzohet më 26 tetor në Londër.

"Unë kujt do t'ia jepja? Lojtarit më të mirë në botë. Kujt do t'ia japin? Sinqerisht, si më të mirët në botë, mendoj se mund të jemi dy: unë dhe Mbappé. Por mendoj se këtë vit do ta meritoja unë, për atë që kam fituar. Të gjithë ata që i shohin ndeshjet e dinë", deklaroi ylli i Barcelonës.

**Yamal: Mund të kisha bërë më shumë në Botëror**

Mes arritjeve të Yamal sezonin e kaluar janë fitimi i La Ligës dhe Superkupës së Spanjës me Barcelonën, ndërsa në aspektin personal ai vendosi rekordet e tij më të mira me 24 gola dhe 18 asistime.

Me kombëtaren spanjolle, Yamal fitoi gjithashtu Kupën e Botës verën e kaluar në Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, vetë 19-vjeçari pranoi se nuk mbeti plotësisht i kënaqur me paraqitjen e tij në Botëror.

"Pas fitimit të Botërorit nuk isha i kënaqur. Është e vërtetë që pata një dëmtim, por kjo nuk ka të bëjë me atë që mendoj. E di që, nëse Botërori do të përsëritej në një moment tjetër, do të kisha qenë në të njëjtin nivel edhe pa dëmtimin", tha Yamal.

"Bëra shumë gjëra që njerëzit nuk i panë. Për shembull, mendoj se për trajnerin është diçka e jashtëzakonshme të ketë një lojtar që tërheq pas vetes tre kundërshtarë. Por nuk isha i kënaqur me veten, sepse e di që një lojtar tjetër me paraqitjen time do të kishte bërë një Botëror të madh. Për mua, mund të kisha bërë më shumë. E ndihmova ekipin, por mezi pres të vijë Botërori i ardhshëm", shtoi sulmuesi i Barcelonës.

**"Dua të mbetem në historinë e futbollit"**

Pavarësisht se është vetëm 19 vjeç dhe ka fituar tashmë një Europian dhe një Botëror, si dhe tre tituj të La Ligës, dy Superkupa të Spanjës dhe një Kupë të Mbretit, Yamal thotë se nuk ka ndërmend të ndalet së fituari trofe.

"Ka pasur yje të mëdhenj në futboll, si Leo, Cristiano apo Diego, të cilin nuk kam pasur mundësi ta shoh duke luajtur, por askush nuk kishte fituar kaq shumë në një moshë kaq

SPORT • KRYESORE



Zhegrova "çmendet" në fund, dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën



Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt



Video/ Zhbllokohet Zhegrova, shpërthen më në fund me fanellën e Juventusit pas një viti. Shikoni dy golat e shqiptarit



Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës



Mançesteri ngjyroset blu, City dominon me 10 lojtarë United dhe i bashkohet Arsenalit në krye me pikë të plota

ME TË LEXUARAT

Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt

"Ky nuk është më futboll", Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-

të re. Është rasti i Pelés, i cili gjithashtu fitoi shumë gjëra herët, por në kohët e fundit nuk ka ndodhur", u shpreh Yamal.

"Ka njerëz që mendojnë se, pasi kam fituar disa trofe, do të relaksohem. Por unë e di se kam ende mijëra gjëra për të bërë për të mbetur në historinë e futbollit", përfundoi ai.

Kandidatura e Lamine Yamal për "Topin e Artë" është mbështetur jo vetëm nga trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, drejtori sportiv Deco dhe presidenti Joan Laporta, por edhe nga trajneri i kombëtares së Spanjës, Luis de la Fuente.

**Top Channel**

## Futboll »



**Fund dramatik për baskët! 10 minuta zjarr i mjaftojnë Atléticos për të bërë "ligjin" në transfertë**
13/09 23:09



**PSG merr fitoren e parë në kampionat, Ferran Torres vazhdon të shkëlqejë dhe vendos duelin ndaj Brestit**
13/09 22:47



**Zhegrova "çmendet" në fund, dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën**
13/09 22:38



**Napoli, Allegri pas fitores: Shpresojmë të jetë një fillim i mirë**
13/09 21:47



**Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit**
13/09 21:24



**Napoli rigjen buzëqeshjen pas 3 humbjeve radhazi, mposht Bolognan**
13/09 20:22

## Kryesore »



**Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane**
14/09 07:48



**Alket Rizai përfshihet në përplasje me armë në Greqi, policia vihet në kërkim të tij. Si arriti të dilte nga burgu**
14/09 07:27



**Deti i trazuar përmbyt tragetin në Indonezi/ Operacion kërkimi për mbi 100 të zhdukur, 6 persona nxirren të pajetë**
14/09 07:19



**Rusia godet një tren në Ukrainë, pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarë të lartë europianë kaluan në të njëjtën linjë**
14/09 07:12



**Java nis me diell! Ja si do të jetë moti këtë të hënë në Shqipëri**
14/09 07:05



**"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar**
14/09 07:01

## La Liga »







Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë nga stadiumet

Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët

Ekskluzive/ "S'kam gjë nga zemra, por…", rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

U përfshi në një aksident automobilistik pasi shënoi golin e fitores, djali i Paolo Maldinit rezultoi pozitiv në testin e alkoolit

Video/ Zhbllokohet Zhegrova, shpërthen më në fund me fanellën e Juventusit pas një viti. Shikoni dy golat e shqiptarit

Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt

Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë

Mançesteri ngjyroset blu, City dominon me 10 lojtarë United dhe i bashkohet Arsenalit në krye me pikë të plota

Zhegrova "çmendet" në fund, dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën



Fund dramatik për baskët! 10 minuta zjarr i mjaftojnë Atléticos për të bërë "ligjin" në transfertë

13/09 23:09



Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës

13/09 18:25



Fillimi katastrofik i sezonit, Valencia shkarkon Drejtorin Sportiv dhe trajnerin

13/09 18:23



La Liga/ Real Madrid kthehet te fitorja, mposht Rayo Vallecanon e Ivan Balliut dhe i bashkohet Barcelonës në krye

12/09 23:00



U largua nga Real Madrid si një dështim i madh, Mastantuono thyen rekorde me Fiorentinën në Itali

12/09 14:00



Barcelona kërkon vazhdimësinë, Flick paralajmëron lojtarët: Duhet ta tregojmë në çdo ndeshje

12/09 13:25

## Sport »



Fund dramatik për baskët! 10 minuta zjarr i mjaftojnë Atléticos për të bërë "ligjin" në transfertë

13/09 23:09



PSG merr fitoren e parë në kampionat, Ferran Torres vazhdon të shkëlqejë dhe vendos duelin ndaj Brestit

13/09 22:47



Video/ Zhbllokohet Zhegrova, shpërthen më në fund me fanellën e Juventusit pas një viti. Shikoni dy golat e shqiptarit

13/09 22:41



Zhegrova "çmendet" në fund, dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën

13/09 22:38



Napoli, Allegri pas fitores: Shpresojmë të jetë një fillim i mirë

13/09 21:47



Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit

13/09 21:24

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Protesta do riorganizim. Thirrjet e qytetarëve në tubimin e 106-të: Të bashkohemi!



Top Channel/ Rusia godet trenin ukrainas afër Polonisë, evakuohet treni ku udhëtonte Boris Johanson



Top News- "Superkompjuteri do të na vrasë brenda 6 muajve", Ish-punonjësi i OpenAi jep alarmin



Top Channel/ Trump sfidon ekspertët: Alarmet për Inteligjencën Artificiale janë të ekzagjeruara



Top News- Viti i Ri Hebre, kryerabinj Yoel Kaplan: Shqipëria të vazhdojë të jetë mikpritëse



Top Channel/ Mitsotakis sfidon Erdoganin: Zotërojmë të drejtën e zgjerimit me 12 milje




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.